**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

**Vend. nr. 01 / 2787 Dt. 11 / 12 / 2023**

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2., të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e VI të mbajtur më datë 01.12.2023, mori këtë:

## VENDIM

Prof. Ass. Dr. Nerxhivane Krasniqi zgjidhet në thirrjen akademike **Profesor i Asociuar** për lëndët nga fusha psikologjisë në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.
Zgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 168, 169 dhe 171 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/742 të datës 28.04.2022.
E përmendura është e obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.
Emërimi zgjatë 4/katër/vite.
Të përmendurës i takon paga në pajtim me Ligjin për pagat në sektorin publik Ligji Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023.
Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

## Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs Ref.nr.01/1637 të dt.13.09.2023, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik një mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit për lëndët: (Psikologji e fëmijës (4); Psikologji e edukimit (4); Psikologji zhvillimore (2); Psikologji e lojës (2); Psikologji e personalitetit (2) në programet e Arsimit Parashkollor dhe Arsimi Fillor; Psikologji socialet në programin master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor).
Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Prof. Ass. Dr. Nerxhivane Krasniqi, i plotëson kushtet për t'u zgjedh në thirrjen akademike Profesor i Asociuar për lëndët e sipërpërmendura.
Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve sipas raportit Ref.nr. 05/2593 të datës 30.11.2023, vendosi që Prof. Ass. Dr. Nerxhivane Krasniqi të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor i Asociuar.
Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike**: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të Universitetit.

Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor
Kryesues i Senatit

Vendimi t'i dërgohet:
1. Të përmendurës
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave